



Për: z. Albin Kurti, Kryeministër i Republikës së Kosovës  
Nga: Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF  
Datë: 11 Shkurt 2020  
Lënda: Letër

I nderuar z. Kurti,

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF, ju uron për detyrën e kryeministrit të Republikës së Kosovës, duke ju dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme.

Përmes medieve, jemi informuar se me ndarjen e ministrive në kabinetin e ri qeveritar, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është ndarë në disa ministri. Transferet sociale janë bartur tek Ministria e Financave, përderisa sektori i punësimit është bartur tek Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike. Ndërkaq, ende mbetet e paqartë se në cilën ministri është bartur apo do të bartet sektori i mirëqenies dhe shërbimeve sociale.

Konsiderojmë që mirëqenia dhe shërbimet sociale duhet të jenë prioritet dhe një ndër shtyllat kryesore të programit të qeverisë. Prandaj kjo duhet të reflektohet edhe në ndarjen e ministrive. Konkretisht, propozimi i KOMF është që mirëqenia dhe shërbimet sociale të kalojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, si në përmbajtje ashtu edhe në emërtim, duke e shndërruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Arsyet kryesore të këtij propozimi janë:

- Shteti është përgjegjës për mirëqenien sociale, organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale dhe familjare në Kosovë dhe të sigurojë që të gjithë banorët e Kosovës të kenë qasje të barabartë në shërbimet sociale dhe familjare pa asnjë dallim. Shteti ka për detyrë të ofrojë shërbime sociale dhe familjare bazuar në legjislacionin në fuqi dhe në konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.
- Mirëqenia sociale mbetet një ndër sektorët më të pazhvilluar, neglizhuar dhe të pa prioritetuar në Kosovë. Të dhënat e fundit nga mjeti matës ndërkombëtar, Indeksi për Mbrojtjen e Fëmijëve tregojnë një gjendje të rëndë të mirëqenies sociale në Kosovë. 17 % e popullësisë në Kosovë jetojnë në varfëri. 6.8% e fëmijëve punojnë në kushte të rrezikshme për të mbajtur familjen. 61.4% e fëmijëve kanë pësuar nga dhuna psikologjike apo ndëshkimi fizik. Vetëm 10% e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet sociale dhe familjare. Shumë fëmijë pa kujdes prindëror, viktimat të abuzimit kanë nevojë për strehim dhe shërbime. Raportet nga institucionet dhe organizatat flasin për rritjen e përfshirjes së fëmijëve në sjellje që janë në kundërshtim me ligjin, përfshirë edhe dhunën, pasojat e së cilës në disa raste janë fatale për vet fëmijët. Poashtu, moshë mesatare e fillimit të përdorimit të substancave narkotike ka rënë nga moshë 21 në moshë 16 vjeç.
- Sipas raporteve dhe studimeve në Kosovë, shërbimet mes sektorëve të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale nuk janë të integruara. Duke parë rëndësinë e madhe për një sistem të integruar të shërbimeve, rekomandohet që shërbimet sociale dhe familjare të integrohen me shërbimet shëndetësore. Kjo mund të bëhet natyrshëm dhe shumë më lehtë nëse të dy këta sektorë funksionojnë nën një ministri. Kjo përkon edhe me organizimin e drejtorive në nivelin komunal, ku drejtoritë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale funksionojnë si një departament i vetëm.

- Bazuar në shumicën e shteteve të BE-së, sektori i mirëqenies sociale reflektohet në kabinetin qeveritar si në përmbajtje ashtu edhe në emërtim. Shembuj të tillë mund të merren në shtetet sikurse Gjermania, Franca, Zvicra, Suedia, Belgjika, Finlanda etj, të cilat kanë në qeveritë e tyre ministrinë për shëndetësi dhe çështje sociale.

Duke marrë parasysh interesin e përbashkët që qytetarët të gëzojnë mirëqenie sociale, KOMF kërkon vëmendjen tuaj si Kryeministër i Kosovës, që dikasteri i mbrojtjes dhe shërbimeve sociale të kalojnë në Ministrinë e Shëndetësisë, si në përmbajtje ashtu edhe në emërtim, duke e shndërruar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kjo për shkak të rëndësisë dhe nevojës për prioritizim dhe zhvillim të këtij sektori.

*Shënim: Shtrirja e institucioneve të shërbimeve sociale në nivel qendror:*

Mirëqenia dhe shërbimet sociale rregullohen kryesisht përmes këtyre ligjeve: Ligji Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës; Ligji Nr.02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; Ligji Nr.06/L-077 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosoves; Ligji Nr.04/L-081 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare; Ligji Nr.03/L-022 për Përkrahje Materiale Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Përhershme; Ligji Nr.03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; Ligji Nr.04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Ligji Nr. 6/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, etj.

Në kuadër të sektorit të mirëqenies sociale në nivel qendror funksionojnë katër (4) institucione të karakterit nacional, të cilat ofrojnë shërbime 24 orëshe për disa kategori të qytetarëve siç janë: Instituti Special në Shtime, Shtëpia me Bazë në Komunitet për Fëmijë në Shtime, Shtëpia e Personave të Moshuar në Prishtinë dhe Strehimorja për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit në Lipjan. Ndërkaq, mekanizmat në nivel qendror për shërbimet sociale janë: Këshilli i Përgjithshëm për Shërbime Sociale dhe Familjare; Paneli për Vendosjen e Fëmijëve për Strehim dhe Adoptim; Komiteti Nacional për Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve; Njësia e Monitorimit dhe Inspektimit për Shërbime Sociale; Njësia e Kontrollit dhe Mbikqyrjes për Skemën e Ndihmës Sociale.

Krahas mandatit për organizimin e ofrimit të shërbimeve sociale për gjithë territorin e Kosovës, sektori i mirëqenies sociale në nivel qendror është përgjegjës për inspektimin dhe licensimin e institucioneve dhe organizatave të nivelit komunal të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare, konkretisht Qendrat për Punë Sociale (40 QPS në 38 komuna), Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat me Aftësi të Kufizuar (12 shtëpi në 12 komuna), Shtëpitë me Bazë në Komunitet për Personat e Moshuar (4 shtëpi në 4 komuna) dhe organizatat e licensuara që ofrojnë aktualisht shërbime sociale (35 OJQ).

Me respekt,

Donjetë Kelmendi  
Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, i themeluar në Qershor të vitit 2011, është një koalicion i përbërë nga 29 organizata jo qeveritare vendore dhe ndërkombëtare të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.

Organizatat anëtare të KOMF janë: Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim –ASTRA, Aksioni për Nëna dhe Fëmijë, Balkan Sunflowers Kosova, Childproof/CIPOF, Education Comes First – ECF, Iniciativa 6, Organizata Rinore Akti – Ora, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, OPFAKKOS, Programi për të Drejtat Civile – CRP/K, PL4Y International, Qendra për Arsim e Kosovës – KEC, Qendra e Kujdesit Ditor PEMA, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit të qenieve njerëzore – MVPT, Qendra për Studime të Avancuara – FIT, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, Save the Children, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë – SDSF, Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë – PRAK Kosova, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës – HANDIKOS, Terre des hommes, The Ideas Partnership, VoRAE, World Vision, Public Organization for Local Initiatives and Supports – POLIS, Network of Peace Movement – NOPM, Qendra Sociale – Edukative SOS Kopshti dhe Nevo Koncepti.